



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.07.2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Lindita Nikolla – Kryetare e Kuvendit

Rendi i ditës:

Vijimin e mbledhjes për mocionin e 1/10-s së deputetëve, përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, “Për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, me dëgjuesën e përfaqësuesit të 15 deputetëve të opozitës për kërkesën e tyre për mocion “Për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”.

Marrin pjesë:

Lindita Nikolla, Ermonela Felaj, Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Enkelejd Alibeaj, Ervin Salianji, Saimir Korreshi dhe Gazment Bardhi, Greta Bardeli dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Taulant Balla dhe Arben Pëllumbi.

HAPET MBLEDHJA

Lindita Nikolla – Mirëdita, të nderuar kolegë!

Meqenëse kuorumi, sipas përcaktimeve të Rregullores, është prezent, e deklaroj të hapur mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet!

Rendi i ditës është vijimi i mbledhjes për mocionin e 1/10-s së deputetëve, përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, “Për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, me dëgjuesën e përfaqësuesit të 15 deputetëve të opozitës për kërkesën e tyre për mocion “Për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”.

Sekretariati jua ka nisur elektronikisht urdhrin për mbledhjen e Këshillit, si dhe kërkesën për mocion të 15 deputetëve të opozitës.

Gjithashtu, ju është dërguar edhe procesverbali i mbledhjes së datës 8.7.2022. A ka ndonjë vërejtje për procesverbalin? Nuk ka.

Atëherë, vijojmë me rendin e ditës.

Në datën 8.7.2022 u vijua me mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet për mocionin e paraqitur nga 1/10-ta e deputetëve përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike me dëgjuesën e deputetes Olta Xhaçka. Në këtë mbledhje u njoftua se nga 15 deputetë është dorëzuar një kërkesë për mocion drejtuar Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, me objekt ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes, zonjës Olta Xhaçka. Objekti i kërkesës ishte i njëjtë me kërkesën që po shqyrtohej nga Këshilli dhe në bazë të neneve 13 dhe 89 të Rregullores së Kuvendit, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet vendosi t’i shqyrtojë së bashku të dyja kërkesat e paraqitura. Në këtë mbledhje u vendos që sot të dëgjohet një përfaqësues i 15 deputetëve për prezantimin e kërkesës për mocion.

Vijojmë me rendin e ditës, me dëgjuesën e përfaqësuesit të 15 deputetëve për prezantimin e kërkesës për mocion.

Keni fjalën për procedurë, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zonja Kryetare!

E mora fjalën për të vënë në dukje, së pari, shkeljet e rënda të procedurës që ju, si drejtuese e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, por edhe kolegët tuaj konsumuat në seancën e kaluar. Seancën e kaluar, siç e pata kërkuar që në krye të herës, ne do të duhet të operonim me dëgjuesën e zonjës ministre. Ju atëherë nuk e pranuat këtë kërkesë. Më pas nuk e di se çfarë ndodhi, por ju u bëtë pishman dhe e thirrët zonjën Xhaçka, e cila pati të drejtën e saj për t'u përfaqësuar me avokat dhe, në fakt, kështu do të duhet të ndodhë, pra të dëgjohet, dhe ajo që ndodhi pasandaj ishte më tepër se e turpshme për traditën e këtij parlamenti, pikë së pari, dhe, së dyti, për të drejtat e deputetëve.

Kur bëhet fjalë për seancë dëgjimore dëgjese, ku i jepet e drejta deputetit, ministrit për t'u dëgjuar, përfshin edhe të drejtën e deputetëve për të bërë pyetje, për të sqaruar, pikë së pari, të gjitha çështjet e faktit, ç'ka ndodhur, si ka ndodhur dhe ku ka ndodhur, për të kuptuar edhe ne nëse kemi të drejtë apo jo në pretendimet tona, por mbi të gjitha për të kuptuar edhe publiku se çfarë ka ndodhur.

Ju, në shkelje flagrante të Rregullores, u ngritët, ikët dhe kjo nuk ju bën nder, së pari, juve dhe, së dyti, edhe këtij parlamenti. Të ikësh me bisht ndër shalë, të fshihesh e t'ia fshehësh të vërtetën, të drejtën publikut, nuk është pjesë e Rregullores, nuk i shërben së vërtetës.

Unë kisha shumë pyetje për t'i bërë avokatit, të cilin e dëgjuam me durim, lexoi gjerë e gjatë, me shpejtësi. Kjo është puna e avokatit, në fakt, por ne, si kërkues, kemi të drejtën për t'i bërë disa pyetje, për të kuptuar më shumë e më mirë, kam përshtypjen se dhe të gjithë kolegët tanë të opozitës, ne që kemi bërë kërkesën.

Të fshihesh, të ikësh nuk i bën shërbim, nëse misioni juaj është t'i bëni shërbim koleges suaj, që do të duhet të jetë atje. Kjo është taktika dhe strategjia më e gabuar.

Për këtë arsye, për të gjitha shkeljet që ndodhën në seancën e kaluar, ju do të duhet t'i rikuperoni jo vetëm për hir të Rregullores, por për hir të së drejtës së deputetëve për të ushtruar të drejtat e tyre, të drejtën për të bërë pyetje, të drejtën për të marrë shpjegime, të drejtën për të kuptuar realisht nëse është duke thënë të vërtetën apo duke mashtruar brenda parlamentit dhe në sy të publikut. Tekefundit kjo është vërtet një seancë që rregullohet nga Rregullorja, por mbi të gjitha do të duhet të ketë edhe një etikë dhe moral për ato çfarë thotë deputeti apo ministri i vendosur, po themi, në akuzë.

Prandaj, zonjë, jeni në kohë të rikuperoni shkeljen që bëtë dhe të na jepni të drejtat tona. Shoh që avokati është prezent, ai ka të drejtën të heshtë, askush nuk e detyron të përgjigjet, por

edhe heshtja në seanca dhe në procese të tilla ka vlerën e vet. Na jepni të drejtën tonë për të ushtruar dhe për të bërë pyetje rreth kërkesës sonë.

E fundit, jo më kot isha unë që e kërkoja thirrjen e zonjës Xhaçka, Kjo procedurë është e tillë që në fund do të duhet të përfundojë në Gjykatën Kushtetuese, nëse ju nuk vendosni ta shkelni Kushtetutën dhe Rregullën.

Të gjithë ne anëtarët e Këshillit për Rregulloren dhe Mandatet, që edhe me profesion jemi juristë, e dimë fare mirë që, nëse do t'i bësh shërbim atij që do të duhet të shkojë të përballet me Kushtetutën dhe me ligjin në Gjykatën Kushtetuese është: bëj ca shkelje procedurale këtu, që t'i ngrejë nesër në Gjykatën Kushtetuese dhe në fond gjykata, me të drejtë, do të thotë: “Ju i shkelni të drejtat, për këtë arsye nuk do ta gjykojmë dot”. Kjo është një strategji dhe një taktikë e dalë boje, prandaj do të duhet sot të rikuperojmë shkeljen që ju bëtë, në mënyrë që nesër, kushdo që është aty, në këtë rast zonja Xhaçka, të përballet realisht me ligjin, me të drejtën dhe me të vërtetën. Kjo është kërkesa që kam.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

E morët fjalën për procedurë, u zgjatët shumë me përsëritje dhe ripërtëritje të vetvetes, duke përdorur fjalë, që, në fakt, edhe nuk janë etike, si: bisht ndër shalë; e pafalshme; e turpshme. Këto janë fjalë që nuk janë pjesë e etikës së një deputeti, aq më shumë të kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Kemi qenë totalisht në respekt të Rregullores dhe të asaj që kemi vendosur këtu për të dëgjuar dhe, kur themi “seancë dëgjimore” nuk parashikojmë pyetje-përgjigje, edhe për faktin që detyra jonë nuk është për të bërë një investigim në themel të çështjes, por për të parë parashtrimet e njëres apo të tjetres palë dhe për të gjykuar mbi këto parashtrime me raportet përkatëse. Kjo është përgjigjja që kam. Kemi qenë në respekt të Rregullores dhe do të vijojmë të jemi në respekt të Rregullores, zoti Alibeaj.

Fjala për zonjën Felaj.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Nuk dua të shtoj diçka thelbësore në raport me ato që ju thatë, por, realisht, referuar nenit 119, paragrafi i parë i Rregullores, “Procedura e konstatimit të kufizimeve”, është e qartë që procedura e mbledhjes që ndjek Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet është një procedurë tipike formale, sepse qartësisht në këtë nen të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë

thuhet që Kuvendi, nëpërmjet Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet verifikon nëse mocioni i paraqitur i plotëson kërkesat juridiko-formale” dhe emërtohen të gjitha kërkesat juridiko-formale.

Në Këshillin për Rregulloren dhe Mandatet u kërkua dhe u pyet nëse është njoftuar personi ndaj të cilit drejtohet kërkesa për mocion dhe është bërë e qartë që në krye të herës që deputetja dhe ministrja për Europën dhe Punët e Jashtme, zonja Xhaçka është njoftuar për kërkesën. Sigurisht që pati një dakordësi mes të gjithë anëtarëve të këtij Këshilli që zonja Xhaçka të mund të njoftohej për atë që ne dëshironim të gjithë si anëtarë të këtij këshilli, që të dëgjohej, dhe është normale, është një nga parimet themelore që përcaktohet në Kushtetutë, që kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të vendoset në lidhje me kërkesën për mocion drejtuar për atë person. Kështu që paraqitja ka ndodhur rregullisht në mbledhjen e kaluar. Personi në fjalë është përfaqësuar në këtë mbledhje nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur nga vetë ajo, i pajisur me prokurën përkatëse dhe çdo gjë ka kaluar normalisht dhe konform Rregullores dhe ligjeve.

Po ashtu, është pranuar edhe konforom Rregullores së Kuvendit, që kërkesa për mocion, e paraqitur nga një tjetër grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë të mund t’i bashkohet të njëjtës mbledhje dhe të trajtohet në të njëjtën mbledhje. Kjo është arsyeja pse sot kemi njërin prej përfaqësuesve të atij grupi deputetësh që ka nënshkruar një kërkesë të dytë, por që është e njëjtë e kërkesën e parë.

Kështu që sot, në fakt, do të duhet të dëgjojmë kërkesën e dytë dhe, meqenëse ky Këshill, por edhe parlamenti e ka të ndaluar nga Rregullorja që të hyjë në thelbin e debatit, sepse ky është një debat që ndodh në Gjykatën Kushtetuese, presupozohet dhe është krejt e qartë që ne dëgjojmë kërkesit, në këtë rast kemi dy kërkes me të njëjtin objekt kërkesë, sigurisht, dëgjojmë edhe palën ndaj së cilës drejtohet kërkesa dhe në fund ky Këshill do të mbajë një qëndrim, sikundër edhe parlamenti do të mbajë një qëndrim, Pra, dëgjesa i shërben influencimit ose jo të vendimmarrjes.

Kështu që ne e kemi diskutuar edhe momentin e pyetjeve dhe, në fakt, Kryetare, do të doja të merreshe procesverballi i mbledhjes së parafundit, ku vetë kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Alibeaj, ka thënë: “Po, është e qartë”. Ne nuk jemi në një komision hetimor, nuk jemi një Këshill që bëjmë një detyrë të tillë, por ama kemi detyrimin të dëgjojmë sa kohë që personi ndaj të cilit mund të drejtohet kërkesa është dakord që të vijë dhe të dëgjohet. Kaq. Nuk kemi asnjë detyrë tjetër për të kryer më shumë se ato që na thotë Rregullorja.

Faleminderit, Kryetare!

Lindita Nikolla – Për çfarë e do fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro, zoti Bardhi!

Gazment Bardhi – Faleminderit, zonja Kryetare!

Është absolutisht e qartë dhe nuk ka nevojë të marrësh procesverbalin, që kryetari i grupit dhe secili prej nesh nga ky krah e di shumë mirë që Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet nuk është komision hetimor dhe nuk ka kërkuar askush që ky Këshill të shndërrohet në një komision hetimor, por secili prej anëtarëve të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, kur të formësojë qëndrimin që thoni ju, e nderuar kolege, do të duhet ta ketë të qartë se cili është versionin që jep njëra nga palët. Ju nuk mund të ndiqni këtu standarde të dyfishta, sepse dëgjova Kryetaren e Kuvendit, që tha: “Dëgjuam njëren palë, dëgjuam dhe palën tjetër”, pra dëgjuam kërkuesin dhe dëgjuam edhe palën që është pjesë e mocionit.

Nëse i kthehem seancës së dytë që kemi bërë në këtë Këshill, ju, që jeni përballë nesh, i keni bërë pyetje palës kërkuese, apo jo, zonja Bushka? Zoti Balla, ju palës kërkuese, pra njëres prej palëve, i keni bërë pyetje. Për çfarë? Për të qartësuar qëndrimin tuaj dhe është e drejta juaj.

Lindita Nikolla – Sepse ishim konform rendit të ditës.

Gazment Bardhi – Pse, këtu jemi jashtë rendit të ditës?

Lindita Nikolla – Kishim diskutime, nuk kishim dëgjësë.

Gazment Bardhi – Pra, njëres palë, kur dëgjohet, siç kemi ftuar sot kolegun Shehaj dhe jemi...

Lindita Nikolla – Në rendin e ditës kishim lënë diskutime dhe bëmë diskutime. Në rendin e ditës së mbledhjes...

Gazment Bardhi – Çfarë e dini ju seancën dëgjimore, e dini seancë leximi?! Seanca dëgjimore, siç ndodh në çdo komision parlamentar, siç po ndodh në këtë moment që ne po flasim, ku kemi një seancë dëgjimore në komisionin...

Lindita Nikolla – Tani, kjo nuk është procedurë, është përsëritje e asaj që tha zoti Alibeaj.

Gazment Bardhi – A ta mbaroj, të lutem?

Jo, zonjë, kam një kërkesë procedurale.

Lindita Nikolla – Bëj kërkesën, mos bëj komente!

Gazment Bardhi – Mos më ndërhy, që ta bëj! Ta mbaroj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk po përsëris asgjë. Në këtë moment që flasim, se nuk i shpikim rregullat në këtë Këshill, kemi një seancë dëgjimore me kandidatët për Avokat të Popullit në sallën ngjitur dhe deputetët po i bëjnë pyetje. Zotëria përfaqëson ministren, që, në fakt, duke mos qenë as komision hetimor, as gjykatë dhe as prokurori, kishte për detyrë të vinte vetë këtu dhe të jepte shpjegime. Së pari, të na shpjegonte ne dhe, së dyti, t'i shpjegonte qytetarëve. Zgjodhi të fshihej pas një avokati, është e drejta e saj, nuk ka nevojë të japë shpjegime ose nuk ka një strategji për të sqaruar opinionin publik...

Lindita Nikolla – Ju lutem, bëni kërkesën për procedurë!

Jeni jurist dhe e dini fare mirë që puna e këtij institucioni normohet me rregulla të veçanta të Rregullores.

Gazment Bardhi – Se jam jurist e di që ju, zonja Kryetare, në mbledhjen e shkuar keni hedhur në erë parlamentarizmin.

Lindita Nikolla – Nuk funksionon si komisionet parlamentare, ju lutem!

Gazment Bardhi – Kishit thirrur një mbledhje të Këshillit dhe e shndërruat nga një seancë dëgjimore në një seancë leximi. Nuk është mbledhja e parë e Këshillit, që mblidhet patjetër...

Lindita Nikolla – Nuk jeni ju personi që e vlerësoni këtë. Është qëndrim personal...

Gazment Bardhi – Patjetër që e vlerësoj. Sa kohë jam anëtar i këtij Këshilli kam gjithë të drejtën për ta vlerësuar.

Lindita Nikolla – Ju lutem, bëni kërkesën!

Gazment Bardhi – Për ju mund të jetë hera e parë që drejtoni një mbledhje Këshilli të Rregullores me këtë objekt, pa diskutim. Nëse keni bërë ndonjë mbledhje të fshehtë, na i njoftoni.

Lindita Nikolla – Ju lutem, t'i lëmë këto komente!

Gazment Bardhi - Është shumë e rëndësishme kjo. Parlamenti ka një traditë. Nuk ka lindur sot kjo çështje. Ky parlament, sa herë ka pasur kërkesa të kësaj natyre, ka zhvilluar seanca dëgjimore me palën...

Lindita Nikolla – Ju jeni deputet për herë të parë, kështu që...

Gazment Bardhi – Kam qenë këshilltar i grupit parlamentar dhe e di shumë mirë se si është procedura. Ju, meqenëse keni në varësi stafin e Kuvendit, nxirrini procesverbalet. Ka qenë rasti i Koço Kokëdhimës, rasti i Rakip Sulit, rasti i Ilir Beqajt e me radhë; verifikojeni nëse ka

pasur seancë dëgjimore, dhe nëse seanca dëgjimore ishte konceptuar ashtu siç të udhëzoi ty nënkryetarja e parlamentit, që do ta kthejmë në seancë leximi apo ishte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos ndërhy, se unë nuk të ndërhyra!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk t'u referova fare. Nuk të kam në referencë.

Ka pasur seancë dëgjimore, pyetje dhe përgjigje. Tani, unë e dëgjova avokatin në seancën tjetër. Kam paqartësi. Që unë të formësoj një qëndrim në përputhje me faktet dhe rrethanat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, a mund t'i thuash të pushojë, nëse mundet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund të ruash etikën, të lutem, dhe kur të flas unë të dëgjosh?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti nuk je papagall, që përsërit fjalët e mia!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si i përsërit fjalët e mia?! Çfarë je ti, papagall?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Papagall je, që përsërit fjalët e të tjerëve?

Lindita Nikolla – Përfundojeni!

Gazment Bardhi - Që unë, si anëtar i Këshillit për Rregulloren dhe Mandatet, të formësoj një qëndrim korrekt, pasi i kam dëgjuar të dyja palët, pasi njëres prej palëve ky Këshill i ka drejtuar pyetje, kam nevojë t'i drejtoj pyetje ministres. Meqenëse ministrja ka vendosur të fshihet pas avokatit, t'i drejtojmë pyetje avokatit. Ka ngritur këtu disa çështje që nuk qëndrojnë dhe unë dua të qartësohem mbi konceptin që ka ngritur si mbrojtje, po themi, ministrja dhe deputetja Olta Xhaçka. Çfarë të keqeje ka këtu?! Si mund t'i shndërroni ju seancat dëgjimore në seancë leximi? Po të jetë për lexim, të dalë në konferencë për shtyp, t'i lexojë e ne ta dëgjojmë nga shtëpia!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lindita Nikolla – Janë të përcaktuara rregullat për veprimtarinë e këtij Këshilli, ka kohën për dëgjesën dhe kohën edhe për diskutime. Ne e respektoam kohën për dëgjesë, do ta respektojmë dhe sot kohën për dëgjesë.

Fjala për ju, zoti Shehaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po të doni, mos e dëgjoni; mbyllini veshët, nëse nuk dëshironi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Shehaj, fjala për ju, ju lutem!

Agron Shehaj – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Më lejoni të sqaroj këtë Këshill, por edhe opinionin publik se prania ime këtu në këtë dëgjesë nuk ka për qëllim të bindë Këshillin që deputetja Olta Xhaçka është në kushtet e papajtushmërisë, sepse kjo është një kompetencë ekskluzive e Gjykatës Kushtetuese.

Prania ime këtu, në këtë Këshill, është që të sqaroj dhe të vërtetoj se mocioni i firmosur nga 15 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë i përmbush të gjitha kushtet e parashikuara nga Kushtetuta, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Rregullorja e Kuvendit dhe, si rrjedhojë, Kuvendi i Shqipërisë është i detyruar të përcjellë pa vonesë kërkesën e deputetëve për gjykim në Gjykatën Kushtetuese.

Dëshiroj të sqaroj që në thelb dy kërkesat e paraqitura kanë të njëjtin qëllim dhe mendoj se ato nga pikëpamja ligjore dhe juridike janë të bazuara dhe duhen dërguar absolutisht para Gjykatës Kushtetuese.

Sidoqoftë, më lejoni të sqaroj shkurtimisht dy momentet thelbësore, të cilat na dallojnë nga kërkesa e deputetëve të tjerë.

Një nga elementet kryesore të kërkesës sonë, që na dallon nga kërkesa e kolegeve tanë, është përdorimi i zonjës Saton nga ana e deputetes Xhaçka për të fshehur shkeljen e pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës. Deputetja Xhaçka dhe bashkëshorti i saj kërkuan ta paraqesin zonjën Saton si investitore strategjike, por ne kemi sjellë prova, që tregojnë se ajo nuk është një investitore e huaj, por është thjesht kunata e deputetes Xhaçka. Zonja Saton nuk është investitore, sepse nuk ka asnjë përvojë në biznes dhe as mjetet financiare për të kryer një investim të tillë. Zonja Saton është shpallur investitore strategjike, sepse ajo është pjesë e familjes Xhaçka. Si provohet? Qartësisht nga adresa e vendbanimit të përbashkët, e vetëdeklaruar nga ana e vëllait Xhaçkës dhe zonjës Saton, postimet në rrjete sociale, si dhe intervista në media e bashkëshortit të ministres.

Me pak fjalë, kemi faktuar që zonja Xhaçka jo vetëm që ka shkelur Kushtetutën, por ajo e ka ditur shumë mirë që ka bërë një shkelje të tillë dhe me veprime fiktive të stimuluar është munduar ta fshehtë këtë fakt, duke bërë një marrëveshje fiktive me kunatën e saj. Pra, ndryshe nga

çdo precedent i mëparshëm në të cilët deputetët kanë qenë me faj kur kanë shkelur këtë dispozitë ligjore, zonja Xhaçka e ka shkelur dispozitën me dashje dhe me qëllim, sepse e ka ditur që po e shkelte dhe është munduar ta fshehtë qëllimisht këtë fakt.

Qëllimi i rregullimit kushtetues të nenit 70 të Kushtetutës është të sigurojë ushtrimin e mandatit të lirë nga ana e deputetit, për të garantuar që ai do të veprojë në interes të popullit dhe jo në interesin e tij personal ose të një grupi të caktuar.

Me këtë veprim, deputetja Xhaçka ka cenuar rëndë besimin e publikut, çka është dhe thelbi i dispozitës kushtetuese

Se dyti, në vlerësojmë se deputetja Xhaçka, në cilësinë e bashkëshortes së shtetasit Artan Gaçi, ka përfituar drejtpërdrejt nga pasuria publike, në kundërshtim me përcaktimin e pikës 3, të nenit 70 të Kushtetutës. Ne nuk e bazojmë kërkesën tonë te konflikti i interesit apo te legjislacioni i posaçëm që rregullon këtë fushë, por jemi të bindur se provat dhe faktet tregojnë se deputetja ka përfituar nga pasuria publike. Pra, ndryshe nga impostimi që kanë bërë kolegët e tjerë, si rrjedhojë edhe e faktimit të marrëveshjes fiktive midis bashkëshortit dhe kunatës së deputetes Xhaçka, ne vlerësojmë se shkelja e pikës 3, të nenit 70 të Kushtetutës është flagrante.

Sigurisht që deputetja me grupin e saj parlamentar pretendojnë të kundërtën, por këtë kontradiktë duhet ta zgjidhë Gjykata Kushtetuese dhe jo Kuvendi.

Vendimi nr. 7, datë 24.02.2016, i Gjykatës Kushtetuese, ka interpretuar në mënyrë përfundimtare përmbajtjen e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, duke arsyetuar midis të tjerash: “Në të tilla raste Kuvendi, nëpërmjet Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, verifikon nëse mocioni i paraqitur i plotëson kërkesat juridiko-formale, siç janë numri i anëtarëve nënshkrues, ekzistenca e dokumentacionit dhe provave...” e të tjera.

Vazhdoj të citoj vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në të cilin thuhet: “Kuvendi në këto raste nuk mund t’i hyjë themelit të çështjes, pra vlerësimit nëse veprimet konkrete të pretenduara të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij, sepse në të kundërt do të ndërhynte në kompetencat që kushtetutëbërësi ia ka njohur vetëm Gjykatës Kushtetuese”.

Sigurisht, për arsyetimin ligjor dhe faktik mund të lexoni kërkesën që ne kemi paraqitur, por, sikundër e thashë, nuk është në tagrin e këtij Këshilli apo Kuvendi ta shqyrtojë në themel këtë, por vetëm nga pikëpamja formale.

Jam marrë me këtë çështje nga fillimi i muajit mars, duke e denoncuar në publik, në media, në konferenca për shtyp nga Partia Demokratike, me kërkesë për informacione nga AIDA,

e cila më ka mohuar të dhënat në lidhje me këtë çështje, me kërkesë për interpelancë me Kryeministrin, i cili po ashtu refuzoi të përgjigjej dhe, së fundi, me kërkesën për heqjen e mandatit. E gjitha kjo sepse është e papranueshme që ministrja e Jashtme mori një pasuri publike në përdorim me vendim të qeverisë në të cilën ajo vetë bën pjesë, duke përdorur kumatën e saj.

Gjithashtu, është e paimagjinueshme se si Kryeministri i Shqipërisë shpall investitor strategjik bashkëshortin e ministres dhe automatikisht ministren.

Por më skandaloze është përshtatja e vendimit nga Kryeministri Rama për të ndihmuar ministren Xhaçka të fshehë përfitimet dhe shkeljen e Kushtetutës, duke përdorur fiktivisht një familjar.

Përfitimi korruptiv për ministren Xhaçka dhe familjen e saj nuk është vetëm vendosja e disa çadrave në plazh, siç tentohet të banalizohet, por me shpalljen e kompanive të familjes Xhaçka si investitore strategjike, familja Xhaçka përfiton nga shteti shqiptar faljen e taksave për 10 vjet, ndërtimin e rrugës për resortin, kanalizimet, ujësjellësit, përdorimin e pronës publike për 30 vjet. Të gjitha këto përfitime e tejkalojnë vlerën e 1 milion eurove. Këto janë vetëm përfitimet materiale, pa llogaritur përfitimet e tjera si lehtësira në procedura, konsolidimi i pronës e të tjera.

Skandali “Xhaçka” është një rast që kërkon të institucionalizojë korrupsionin, duke legjitimuar përfitimet direkte në favor të anëtarëve të qeverisë. Kjo është arsyeja pse Xhaçka duhet ndëshkuar fillimisht nga Gjykata Kushtetuese me heqjen e mandatit dhe me pas duhet hetuar penalisht nga SPAK-u.

Kërkoj në emër të deputetëve që kanë paraqitur kërkesën, që ajo t’i përcillet për shqyrtim, sipas dispozitave kushtetuese dhe interpretimit të Gjykatës Kushtetuese, kësaj të fundit, sa më parë, për të shmangur këtë papajtueshmëri që zonja Xhaçka ka me mandatin e deputetit.

Shumë faleminderit!

Lindita Nikolla – Meqenëse avokati është këtu, nëse ka prapësime për çështjen që u prezantua, mund të flasë sot ose mund të na i dërgojë me shkrim brenda një jave. Ndoshta më mirë të na i dërgoni me shkrim brenda një jave.

Zoti Avokat, mund të merrni kohë dhe mund të na i dërgoni me shkrim brenda një jave.

Genc Çifligu – Do t’jua paraqesim me shkrim brenda një jave në Kuvend të gjitha pretendimet tona në lidhje me kërkesën e re, që u lexua nga grupi i ri, për mocionin për mbarimin apo pavlefshmërinë e mandatit të deputetes, zonjës Olta Xhaçka.

Lindita Nikolla – Dakord.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka nevojë për procedurë tani. Procedura u ezaurua.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në tagrin e drejtueses.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në anën procedurale...

Gazment Bardhi – Zonja Kryetare, ne jemi organ kolegjal dhe vendimet i marrim si organ kolegjal. Nuk vendos ti për ne. Kjo është e para.

E dyta...

Lindita Nikolla – Vendimet si organ kolegjal i kemi marrë, jemi duke i diskutuar çështjet dhe...

Gazment Bardhi - Procedurën që do të ndjekë Këshilli, do ta vendosë Këshilli, nuk e vendosni ju.

Lindita Nikolla – Patjetër.

Gazment Bardhi – Ju keni dy muaj që e çoni këtë një javë, një javë e një javë, ndërkohë që keni një deputet në Kuvend që ushtron mandatin në papajtueshmëri.

Lindita Nikolla – Nuk kemi 2 muaj, kemi aq kohë sa na lejon Rregullorja dhe në respekt total të saj.

Gazment Bardhi - Ke fiks 2 muaj!

Zonjës Xhaçka besoj se ia keni njoftuar mocionin, apo jo? Edhe avokatin për seancën e sotme e keni njoftuar ju, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk erdhi prezent, se nuk lejohet të hyhet në Kuvend...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka ardhur pa njoftuar ai? Avokati ka ardhur i njoftuar nga Kryetarja e Kuvendit për seancën e sotme, apo jo?

Lindita Nikolla – Patjetër.

Gazment Bardhi – I kemi dhënë një javë kohë. Nëse ka parashtrime për këto çështje, të na i vërë në dispozicion sot.

Lindita Nikolla – Jo sot, do të marrë kohën e caktuar.

Gazment Bardhi – Ka marrë një javë kohë, zonjë!

Lindita Nikolla – Nuk i vendos dot ti kushtet.

Gazment Bardhi – Po kush i vendos, ti? Se do të mbrosh Olta Xhaçkën dhe ta shtysh dy muaj.

Lindita Nikolla – Absolutisht! Dua të mbroj mbarëvajtjen, konform rregullores së Këshillit për Mandatet, për të krijuar të gjitha mundësitë që ne të kemi një qartësi para se të marrim vendime.

Gazment Bardhi – A e ke njoftuar Olta Xhaçkën për seancën e sotme? A e ke njoftuar mocionin...

Lindita Nikolla – Mbledhjen për sot e deklaroj të mbyllur!

Brenda javës ju do të na sillni me shkrim.

Gazment Bardhi – Ju këtë punë keni, shkelni ligjin, shkelni Kushtetutën, ikni nga mbledhja dhe fshiheni, se hajduti...

MBYLLET MBLEDHJA